



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 6957 Prot.

Elbasan, më 1 7 2025

Lënda: Mbi aktin e këshillit bashkiak.

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” datë 27.10.2016, ndryshuar me ligjin nr.36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, datë 18.04.2024, neni 1, pasi verifikuam aktin tuaj nr.53, datë 24.06.2025 "Për dhënie ndihme financiare", ju sqarojmë se;

Referuar shkronjes a) te nenit 8 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” është përcaktuar se; “Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore: a) verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësave me **karakter normativ** të organeve të vetëqeverisjes vendore”. Ne piken 2 të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” është përcaktuar se; “Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësave me **karakter normativ** të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre”.

Referuar neni 1 te ligjit nr.36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” është përcaktuar se; “**Akte me karakter normativ**” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”

Referuar shkronjes a) te pikes 1 te ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, miratuar në datë 30.04.2015 është përcaktuar se; “1. “Akti administrativ”: a) “**Akti administrativ individual**” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;”.

Përsa më siper duke verifikuar aktet tuaja konstatohet se nuk janë të karakterit normativ por janë akte me karakter individual, në këto kushte nuk janë objekt verifikimi ligjshmërie të Prefektit të Qarkut Elbasan. Theksojmë se për këtë kategori aktesh Këshilli Bashkiak Librazhd duhet të përcaktojë kriteret se si do të aplikohet fondi përkatës për dhënien e ndihmës financiare për të evidentuar edhe target grupin i cili do të jetë përfitues i këtij fondi. Ju sugjerojmë se në të ardhmen aktet me karakter individual nuk duhet të depozitohen në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan.

**PREFEKTI**
Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 695

27.6.2025



Nr. 4457 prot

VENDIM

Datë.26.06.2025

Nr.53 dt.24.06.2025

“PER DHENIE NDIHME FINANCIARE ”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”, Udhezimi plotësues nr.2 date 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë 24.06.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë dhënie e ndihmës financiare z.Teki Goli nga fshati Zdrajsh Njësia Administrative Orenjë në masën 50,000 lekë si familje në vështirësi financiare .
 2. Fondi prej 50,000 lekë do të përballohet nga fondi i miratuar në buxhetin e Bashkisë Librazhd për vitin 2025 “Ndhmë Financiare” në strukturën buxhetore si më poshtë:
- | Grupi | titulli | kapitulli | artikulli | vlera |
|-------|---------|-----------|-----------|------------------------------|
| 00 | 1110 | 01 | 606 | 50,000 lekë Ndhmë financiare |
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social, Sektori Financës .
 4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU

